

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data: 19.03.2020]

Për: Operatorin Ekonomik INFORM ALBANIA shpk me adrese Rr. Çerçiz Topulli, 17 – 1051, Kashar – Tirane.

Procedura e prokurimit: E hapur – Sherbime

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-46784-12-24-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Printim i fatures te energjise elektrike dhe zarfimi ne versionin Selfmailer me afat kohor për ekzekutimin 12 muaj nga data e nenshkrimit te kontrates

Publikime të mëparshme: Buletini Nr. 52 datë 30 Dhjetor 2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët i ofertes te kualifikuar

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik INTERLOGISTIC shpk me nr. NIPT K21605003M me vlere oferte 40,248,000 (Dyzet milion e dyqind e dyzet e tete mije) leke pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik INFORM ALBANIA shpk me nr. NIPT L11518003F me vlere oferte 43,368,000 (Dyzet e tre milion e treqind e gjashtedhjetë e tete mije) leke pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik AdelCo shpk me nr. NIPT L22117021M me vlere oferte 44,304,000 (Dyzet e kater milion e treqind e kater mije) leke pa TVSH.

Eshtë skualifikuar ofertuesi si mëposhtë:

1. INTERLOGISTIC shpk me nr. NIPT K21605003M

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Autoriteti Kontraktor, ne dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca nr. 8, ne Kriteret e Veçanta per Kualifikim, pika 3.3.1 te “Kapacitetit Teknik”, ka kerkuar “Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 17,700,000 (shtatembedhjetë milion e shtatëqind mije) leke pa tvsh.
- si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Nisur nga sa mesiper Operatori Ekonomik INTERLOGISTIC shpk nuk provon shërbime të ngjashme të kryera. Konkretisht referuar faturave tatimore të paraqitura shërbimi i kryer rezulton të jete “printim zarfim i dokumentave...” i cili referuar specifikimeve të shërbimit objekt kontrate “printimi dhe zarfimi në versionin selfmail” nuk konsiderohet shërbim i ngjashëm.

2. Autoriteti Kontraktor, në dokumentat Standarte të Tenderit, shtojca nr. 8, në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, pika 3.3.8 të “Kapacitetit Teknik”, ka kërkuar që Operatori ekonomik duhet të disponojë një soft menaxhimi dhe monitorimi të punës (printimit dhe zarfimit të faturave) në kohe reale. Për të provuar disponimin e këtij softi duhet të paraqesë licencën e software-it dhe/ose autorizim prodhuesi/distributor të autorizuar të softit, fature tatimore blerje, deklarate zhdoganimit ose cdo formë tjetër disponimi që njëh Kodi Civil i RSH.

Nisur nga sa mesiper Operatori Ekonomik INTERLOGISTIC shpk nuk paraqet dokumentacion për të provuar disponimin e software-it të kërkuar. konkretisht nuk paraqet licencën e software-it dhe/ose autorizim prodhuesi/distributor të autorizuar të softit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik INFORM ALBANIA shpk me adresë Rr. Çerçiz Topulli, 17 – 1051, Kashar – Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 43,368,000 (Dyzet e tre milion e treqind e gjashtëdhjetë e tete mijë) leke pa TVSH / pikët totale të marra 100/është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë OSHEE Group sh.a me adresë Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirana, Albania / Njësia e Prokurimit, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes / publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 44,304,000 (Dyzet e katër milion e treqind e katër mijë) leke pa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 21.02.2020

Ankesa:

- Ne datën 28.02.2020, me nr. 2775 Prot., nga Operator Ekonomik **“INTERLOGISTIC” shpk** është paraqitur formulari i ankeses për procedurën e prokurimit me objekt **“Printim i fatures të energjisë elektrike dhe zarfimi në versionin Selfmailer”** e vlerësuar në datë 21.02.2020 nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Operatori Ekonomik **“INTERLOGISTIC” shpk** me shkresën nr. 2775 prot., datë 28.02.2020 (formulari i ankeses) kërkon pezullimin e procedurës, nxjerrjen e një klasifikimi të ri, pasi sipas Operatorit Ekonomik oferta e paraqitur është oferte e suksesshme.

Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 2775/1 prot., datë: 28.02.2020, mbështetur në nenin 63 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “për prokurimin publik”, i ndryshuar, urdheron pezullimin e procedurës dhe shqyrtimin e ankesës nga personi i caktuar në urdher.

Me vendimin nr. 2775/2 prot., datë: 02.03.2020 të zyrtarit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesës me nr. 2775 Prot., datë: 28.02.2020 nga Operator Ekonomik **“INTERLOGISTIC” shpk**, nuk është pranuar ankesa (pretendimet) e paraqitur.

Me shkresën nr. 2775/3 prot., datë: 02.03.2020 i është komunikuar Operator Ekonomik **“INTERLOGISTIC” shpk**, vendimi mbi nr. 2775 prot., datë 28.02.2020.

[Titullari i autoritetit kontraktor]